



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E TATIMEVE



European Bank
for Reconstruction and Development

INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT

Person Fizik me xhiro
deri 2 milionë Lekë

Person Fizik me xhiro deri 2 milionë lekë

1. Quresh Person Fizik nëse:

- Je një individ dhe kërkon që të ushtrosh një aktivitet tregtar të pavarur;
- Je i vetëpunësuar, i vetëm dhe/ose me punëmarrës anëtarë të papaguar të familjes dhe persona të tjerë.
- Regjistrohesh në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) si person fizik;

Për detaje kliko:

<http://www.qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-biznesit/regjistrimi-fillestar/>

2. Regjistrimi i biznesit në QKB është i detyrueshëm:

- Gjithmonë para nisjes efektive të veprimtarisë së biznesit tënd.

3. Vendet ku mund të regjistrohesh:


- Në sportelet e QKB-së ose të autorizuara prej saj në bashki dhe dhomat e tregtisë;
- Në sportelet e Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA); dhe,
- Në platformën elektronike e-albania.

4. Për regjistrimin e biznesit kërkohen disa dokumenta dhe të dhëna të detyrueshme:

a. Dokumentat:

- Kartë identiteti e personit që do te regjistrohet ;

Kujdes: Në platformën e-albania ndiq udhëzimet për mënyrën e aplikimit.



b. Të dhënat minimale të detyrueshme për t'u përfshirë në kërkesën për regjistrim:

- i. Lloji i aktivitetit ekonomik ;
- ii. Adresa e vendit të biznesit ;
- iii. Statusi si i vetëpunësuar i vetëm dhe/ose me punëmarrës anëtarë të papaguar të familjes apo punëmarrës të tjerë;

Kujdes: Një individ, mund të regjistrohet vetëm një herë në QKB si Person Fizik. Për çdo shtim veprimtarie, pajisesh me të njëjtin NIPT me numër serial të ndryshëm.

c. Xhiroja vjetore e parashikuar:

Përbën bazën mbi të cilën përcaktohen detyrimet/përgjegjësitë tatimore të personit fizik që në momentin e regjistrimit.

Më poshtë paraqiten llojet e detyrimeve tatimore sipas nivelit të xhiros.

Tabela 1 – Llojet e detyrimeve tatimore në varësi të xhiros vjetore të biznesit

Xhiroja vjetore (në lekë)	Përgjegjësitë tatimore / Llojet e Detyrimeve Tatimore				
	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP	Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSh)	Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin	Tatim Mbi Fitimin	Tatimi në Burim
0-2 milionë	Po	Jo	Po	Jo	Po
Mbi 2 deri 5 milionë	Po	Po	Po	Jo	Po
Mbi 5 deri 8 milionë	Po	Po	Po	Jo	Po
Mbi 8 milionë	Po	Po	Jo	Po	Po

Kujdes: Meqenëse nuk je i regjistruar për TVSh, nuk mund të kreditosh (rimbursosh) TVSh-në e paguar për mallrat/shërbimet e blera.

Megjithëse je nën kufijtë e xhiros për regjistrim si pages i TVSh-së:

1. Ke të drejtë të regjistrohesh vullnetarisht si pages i TVSh-së.
2. Je i detyruar që të regjistrohesh për deklarimin dhe pagimin e TVSh-së, nëse:
 - a. Blen mallra apo shërbime importi për t'i shitur dhe jo për t'i investuar në biznes;
 - b. Ushtron një profesion që i nënshtrohet pagesës së TVSh-së, pavarësisht nga xhiroja

5. Procesi i regjistrimit në QKB përfundon mbasi ke:

- Plotësuar dhe dorëzuar formularin e regjistrimit me të dhënat e mësipërme;
- Marrë certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit, që quhet Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT).

Ky proces zgjat një ditë pune.

Të nesërmen mund të verifikosh statusin e kërkesës për regjistrim duke klikuar në faqen elektronike të QKB-së: <http://www.qkb.gov.al>

- Në rast se kërkesa pezullohet, ke 21 ditë kohë për të plotësuar mangësitë.
- Në rast se kërkesa e regjistrimit refuzohet, bëhet kërkesë e re, pas eliminimit të shkaqeve të refuzimit.

6. Regjistrimi i biznesit në QKB është njëkohësisht edhe:


Regjistrim i tij pranë Administratës Tatimore qendrore dhe vendore, regjistrim në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe regjistrim pranë inspektoratit të punës.

7. Menjëherë pas regjistrimit fillestar në QKB:

- Hap llogarinë tënde në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) duke përdorur:
 - NIPT-in, si emër përdoruesi, dhe
 - “Tatimetemia12”, si fjalëkalim fillestar.

Kujdes:

- Përgjegjësitë tatimore fillojnë nga data e regjistrimit në QKB.
- Verifiko dhe qartësohu për përgjegjësitë tatimore të listuara në kategorinë “Profili im”.
- Deklarimet për detyrimet tatimore bëhen vetëm nëpërmjet kësaj llogarie elektronike.
- Nëse ke probleme gjatë regjistrimit dhe përdorimit të llogarisë tënde elektronike:
 - Telefona Qendrën e Thirrjeve të DPT në numrin e telefonit 0800 00 02;
 - Merr udhëzime drejtpërsëdrejti në seksionin “live chat” të këtij shërbimi;
 - Paraqitu personalisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), ose
 - Kliko në faqen elektronike të DPT: <https://www.tatime.gov.al/c/7/200/udhezues-perdorimi>



8. Menjëherë pas hapjes së llogarisë elektronike në DPT:

a. Deklaro në llogarinë tënde elektronike :

- i. Jo më vonë se 2 ditë pas regjistrimit në QKB, vetëm veten tënde, nëse ke të punësuar dhe punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç;
- ii. Jo më vonë se 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklarates së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore vetëm veten tënde, nëse je i regjistruar si i vetëpunësuar i vetëm dhe nuk ke të punësuar dhe punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç. Në këtë rast llogaritja e detyrimit fillon që nga data e regjistrimit në QKB

b. Shko pranë Zyrës së Taksave Vendore të Bashkisë tënde:

- i. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit; dhe
- ii. Kërko njoftimin për llojet, shumat dhe afatet e pagesës së taksave të tua vendore.

Kujdes: Nëse ambientin e merr me qera, pronari duhet të ketë paguar taksën e pasurisë së paluajtshme.

c. Shko në DRT për;

- i. T'u pajisur me bllokun e faturave të thjeshta tatimore të shitjes, dëftesat tatimore, faturat e shoqërimit dhe librin e blerjeve dhe shitjes për biznesin e vogël pa TVSh; dhe
- ii. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit.

(Ky dokument mund të dorëzohet edhe elektronikisht nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik në www.tatime.gov.al)

- d. Pajisu me kasë fiskale, pranë shoqërive të autorizuara, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit, nëse do të shesësh me para në dorë;

Kujdes: Deri në ditën e pajisjes me kasë fiskale dhe/ose në rast se kasa fiskale është jashtë funksionit, duhet të lëshosh dëftesë tatimore për çdo shitje të kryer.

- e. Hap llogari bankare në emër të Personit Fizik për arkëtimet dhe pagesat e biznesit tënd.

Kujdes: Nuk mund të bëhen transaksione me para në dorë për shuma mbi 150,000 lekë midis dy personave tregtarë fizikë apo juridikë.

**BIZNESI
I VOGËL**



KËNDI
I ASISTENCËS

9. Në marrëdhënie me administratën tatimore ke të drejtë për:

- a. Informim dhe sqarim për legjislacionin;
- b. Ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave tua;
- c. Marrje njoftimi paraprakisht për aktet që lidhen me detyrimet tatimore;
- d. Kontrollë tatimore në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve të ligjit;
- e. T'u dëgjuar para marrjes së vendimeve që lidhen me biznesin tënd;
- f. Të marrë informacion nga dosja jote tatimore;
- g. Përfaqësim me persona të autorizuar prej teje;
- h. Ankimim ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës;
- i. Një shqyrtim të pavarur administrativ të ankesave të bëra;
- j. Marrë ose printuar nga sistemi elektronik (e-albania) vërtetime për:
 - i. Përgjegjësitë tatimore;
 - ii. Detyrimet e paguara;
 - iii. Pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
 - iv. Xhiron e 3 viteve të fundit;
 - v. Statusin si tatimpagues (aktiv, pasiv) dhe afatet konkrete për secilin rast;
 - vi. Posedim mjeti.
 - vii. Për regjistrim të investitorit;
 - viii. Për kontributet e paguara për individin;
 - ix. Vërtetim për individë të pargjistruar.

10. Dokumentat që duhen afishuar në ambientet e biznesit:

- a. Certifikata e Regjistrimit (NIPT-i);
- b. Lista e çmimeve të shitjes për çdo mall/shërbim që ofron;
- c. Njoftim-kujdes për klientët që të marrin kuponin tatimor për blerjet me para në dorë si dhe që kanë të drejtë për të mos kryer transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor.



11. Për dokumentimin e shitjeve dhe blerjeve duhet të:

- a. Lëshosh kupon tatimor për çdo shitje me para në dorë;
- b. Lëshosh faturë te thjeshtë tatimore, së bashku me kuponin tatimor kur:
 - i. Bën shitje tek një tregtar tjetër, dhe
 - ii. Blerësi individ të kërkon vetë një faturë tatimore.
- c. Lësho faturë te thjeshtë tatimore në rast se shet mallra ose kryen shërbime me pagesë të mëvonshme në bankë;
- d. Lësho faturë tatimore nga blloku yt, me shënimin “Faturë e lëshuar nga blerësi”, për blerjet që bën nga individë, persona fizikë jo-tregtarë, dhe shëno në të numrin e kartës së identitetit të tij, në mënyrë që fatura të jetë e vlefshme për qëllime tatimore;
- e. Plotëso faturat e shitjes me të gjitha të dhënat e kërkuara: datën, të dhënat e blerësit, emrin tregtar/emrin e individit, NIPT/Nr. personal, adresën, transportuesin, përshkrimin e mallit/shërbimit, njësinë, çmimin, vlerën, shumën e faturës, etj;
- f. Bëj mbylljen e kasës fiskale, në fund të çdo dite pune dhe transmeto të dhënat e saj. Të nesërmen regjistrimi i kuponave fillon nga e para;
- g. Merr faturë tatimore të thjeshtë ose me TVSh (në varësi të përgjegjësisë tatimore të shitësit) për çdo blerje të kryer për biznesin tënd.

Kujdes: Për moslëshim të faturës, mosdokumentim të mallrave në ruajtje dhe lëvizje mallrash të pashoqëruar me dokumenta tatimore, administrata tatimore të regjistron me detyrim si pagues i TVSh-së.

12. Deklarimi i të punësuarve dhe të larguarve nga puna dhe i pagave të tyre:

- a. Marrja në punë dhe largimi nga puna deklarohen në llogarinë elektronike:
 - i. 1 ditë para marrjes në punë, dhe
 - ii. Brenda 10 ditëve nga data e largimit nga puna.
- b. Njihen si shpenzime të zbritshme vetëm pagat që paguhen nëpërmjet sistemit bankar.

13. Detyrimet Tatimore që duhen paguar

Shuma e detyrimeve tatimore llogaritet duke shumëzuar shumën (bazën) mbi të cilën llogaritet tatimi me shkallën tatimore të caktuar për secilin lloj të tatimit.

Tabela 2–Detyrimet Tatimore për personat fizikë me xhiro vjetore deri 2 milionë Lekë

Nr.	Lloji i Detyrimit	Shkalla tatimore	Shuma mbi të cilën zbatohet shkalla tatimore
1.	Kontribute për sigurime shoqërore për të vetëpunësuarin dhe punonjës të papaguar të familjes	23%	Paga për efekt sigurimi, por jo nën pagën minimale dhe mbi pagën maksimale mujore (26,000-114,670 lekë)
2.	Kontribute për sigurime shëndetësore për të vetëpunësuarin dhe punonjës të papaguar të familjes	3,4%	Dyfishi i pagës minimale mujore (2x26,000 lekë)
3.	Kontribute për sigurime shoqërore të punëmarrësit	24.5%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale dhe jo mbi pagën maksimale mujore (26,000-114,670 lekë)
4.	Kontribute për sigurime shëndetësore të punëmarrësit	3.4%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale mujore (26,000 lekë)
5.	Tatim mbi të ardhurat personale nga punësimi të punëmarrësit	0% 13% 23%	Paga mujore bruto deri në 30,000 lekë; Pjesa e pagës mujore bruto mbi 30,000-150,000 lekë Pjesa e pagës mujore bruto mbi 150,000 lekë
6.	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0%	Fitimi bruto (para tatimit)
7.	Tatim në burim	15%	Shuma bruto e pagesës për individë të peregjistruar

14. Periudhat dhe mënyra e deklarimit të detyrimeve tatimore

Periudhat për të cilën bëhet deklarimi i detyrimeve tatimore varen nga lloji i detyrimit (Tabela 3). Deklarimi i parë për detyrimet tatimore bëhet brenda datës 20 të muajit ose tremujorit pas muajit të regjistrimit, në varësi të llojit të detyrimit.

Tabela 3 - Periudha dhe mënyra e deklarimit të Detyrimeve Tatimore

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Afati i deklarimit	Mënyra e paraqitjes së deklaratës
1.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/TAP	Tremujore	Online
2.	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	Vjetore	Online
3.	Tatimi në burim	Mujore	Online

15. Afatet e deklarimit dhe pagesës së Detyrimeve Tatimore

Afati i deklarimit të detyrimeve tatimore është i ndryshëm në varësi të llojit të detyrimit. Data e fundit e deklarimit është edhe data e kryerjes së pagesës. Më poshtë janë dhënë datat e fundit të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore dhe vendi i kryerjes së pagesës.

Tabela 4 - Afatet e deklarimit dhe pagesës si edhe vendi ku kryhet pagesa e detyrimeve tatimore

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Afati i deklarimit dhe pagesës së detyrimit	Vendi i pagesës
1.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/TAP	Brenda datës 20 të muajit pas mbylljes së tremujorit (20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar)	Në bankë
2.	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	Brenda datës 10 shkurt të vitit pasardhës (Vetëm për deklarim dhe jo pagesë)	Nuk ka, Shkalla 0%
3.	Tatimi në burim	Çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës	Në bankë

Kujdes: Nëse detyrimet tatimore janë krijuar si rezultat i vlerësimit të bërë nga administrata tatimore duhet të paguhën brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

16. Ndryshimet e Deklaratave Tatimore për gabime ose pasaktësi bëhen nëse:

- Nuk kanë kaluar më shumë se 36 muaj nga deklarimi fillestar dhe nuk je kontrolluar nga administrata tatimore gjatë kësaj kohe;
- Je kontrolluar nga tatimet, por deklaron një detyrim tatimor më të madh se sa kontrolli;

17. Detyrimet mund të paguhen edhe me këste nëse:

- a. Je në vështirësi financiare;
- b. Lidh një marrëveshje për kushtet e pagesës me këste me DRT;
- c. Parapaguan 20% të detyrimit;
- d. Garanton mbylljen e detyrimeve brenda muajit Dhjetor të vitit pasardhës, në të kundërt marrëveshja nuk pranohet ose kërkohet të vendosësh garanci bankare.

Kujdes: Marrëveshja e pagesës me këste mund të prishet në çdo kohë nëse:

1. Pagesat nuk bëhen në përputhje me marrëveshjen;
2. Nuk paguan detyrimet e reja që lindin pas marrëveshjes;

Nuk pranohet të lidhet marrëveshje e pagesës me këste për detyrim tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

18. Rimbursimet ose Kompensimet e Detyrimeve Tatimore bëhen duke:

- a. U kompensuar automatikisht nga sistemi informatik tatimor, për çdo detyrim tatimor të paguar tepër, brenda të njëjtit lloj detyrimi, përveç detyrimit të kontributeve të sigurimeve;
- b. Kërkuar kthimin e parave për shumat e detyrimeve tatimore të paguara më tepër;
- c. E lënë pagesën e bërë tepër për llogari të detyrimeve të ardhshme;
- d. I kërkuar administratës tatimore kalimin e detyrimeve të paguara tepër për llogari të detyrimeve të tjera, përveç kompensimit të kontributeve për sigurimet.

19. Mosdeklarimi i Detyrimit Tatimor dhe mospagesa në afat kanë kosto:

- a. Vendoset gjobë për mosdeklarim;
- b. Pas 5 ditëve, nga data e detyrimit për të deklaruar, administrata tatimore të njofton me letër kujtesë për detyrimin;
- c. Brenda 10 ditëve pas njoftimit administrata tatimore bën vlerësim automatik të deklaratës së munguar, i cili:
 - i. Nuk mund të ankimohet, por
 - ii. Mund të anulohet nëse paraqet deklaratën brenda afatit të ri të përcaktuar.
- d. Sistemi elektronik fillon llogaritjen automatike të gjobave dhe kamatëvonesave për detyrimin e papaguar.

20. Afati dhe pagesa e Detyrimeve të Taksave dhe Tarifave Vendore

- a. Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore përcaktohen me ligj dhe me Vendimet e Këshillave Bashkiake (VKB);
- b. Taksat vendore llogariten dhe paguhen në bazë vjetore, përveç vitit të regjistrimit ose pushimit/çregjistrimit të aktivitetit që llogariten proporcionalisht për periudhën e vitit fiskal që biznesi është aktiv;
- c. Taksat dhe Tarifat ndryshojnë sipas llojit të biznesit dhe natyrës së veprimtarisë së tij, por më tipiket janë:
 - i. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, ku përfshihen ndërtesat dhe tokat bujqësore;
 - ii. Tarifat e pastrimit, zënies së hapësirave publike, tabelës dhe të tjera që vendosen me VKB.

21. Përgjegjësitë tatimore mund të ndryshojnë edhe pas regjistrimit fillestar

a. Për TVSh-në:

- i. Duhet të regjistrohesh për TVSh 15 ditë nga data kur xhiroja tejkalon kufirin 2 milion lekë.
- ii. Llogaritja e TVSh-së bëhet për shumën për të cilën është tejkaluar kufiri
- iii. Llogaritja e kufirit minimal të xhiros për vitin e parë bëhet duke shumëzuar numrin e muajve nga data e regjistrimit në QKB me xhiron proporcionale mujore 166,667 lekë;
- iv. Regjistrimi si pagues i TVSh-së të jep të drejtën e zbritjes së TVSh-së për mallrat gjendje, të blera me faturë tatimore me TVSh para regjistrimit në këtë përgjegjësi, por jo më herët se 12 muaj;
- v. Në rast se xhiroja faktike bie nën kufirin e regjistrimit për TVSh, çregjistrimi bëhet me një kërkesë drejtuar DRT, por hyn në fuqi 12 muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës.

b. Për tatimin mbi fitimin:

Në rast se xhiroja në një vit kalendarik e kalon kufirin 8 milionë lekë, brenda 15 ditëve nga data e tejkalimit të këtij kufiri duhet të bësh kërkesë për t'u regjistruar si pagues i tatimit mbi fitimin.



Kujdes: Në varësi të fushës së aktivitetit, mund të duhet të regjistrohesh edhe për përgjegjësi tatimore të tjera specifike si p.sh. renta minerare

22. Ndryshime të organizimit dhe vendndodhjes që duhen regjistruar në QKB

- Ndryshimi i adresës së biznesit;
- Hapja/mbyllja e adresës sekondare;
- Ndryshim/shtimi i objektit të veprimtarisë;

Ndryshimet deklarohen në QKB nga personi fizik ose çdo person i autorizuar prej tij.

Kujdes: Mos fillo aktivitet në adresë dytësore, pa kryer më parë regjistrimin në QKB.

- Merr kasë fiskale për çdo adresë dytësore nëse kryen shitje me para në dorë.
- Konsiderohen si adresë dytësore edhe mjetet për:
 - Shitjen e mallrave derë më derë dhe
 - Transportin e mallrave dhe udhëtarëve për të tretë.
- Për mjetet e shoqërisë që përdoren vetëm për transportin e mallrave për vete ose blerësin tënd merr një vërtetim për posedim mjeti, online në portalin e-albania

23. Mbajtja e të dhënave tatimore dhe kontabël

- Dokumentat që duhet të mbahen për qëllime tatimore janë: faturat e blerjes dhe shitjes, librat e blerjeve dhe shitjeve, inventari i mallrave dhe çdo regjistrim tjetër i kërkuar nga ligji tatimor dhe i kontabilitetit;
- Dokumentat tatimore ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e mbylljes së vitit fiskal.
- Kontabiliteti dhe përgatitja e pasqyrave financiare vjetore bazohen në ligjin për kontabilitetin dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar.



24. Kontrolli tatimor

- a. Administrata tatimore ka të drejtë të kontrollojë deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat dhe shpenzimet ;
- b. Llojet e kontrollit tatimor janë:
 - i. Kontroll i thelluar në vend, me njoftim paraprak 30 ditë;
 - ii. Vizita fiskale, me njoftim paraprak 10 ditë;
 - iii. Verifikim në terren, pa njoftim paraprak por me një urdhër ditor të punës.

25. Mbledhja me forcë e Detyrimit Tatimor bëhet kur:

- a. Detyrimet tatimore nuk janë paguar sipas afateve ligjore;
- b. Nuk ke ushtruar të drejtën e ankimit në Drejtorinë e Apelimit Tatimor (DAT);
- c. Kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Për mbledhjen ndërmerren këto hapa:

- i. Njoftimi i tatimpaguesit me kërkesë për të paguar/ Urdhër bllokim i llogarive bankare me postë rekomande ose në rrugë elektronike/ sigurimi i detyrimit tatimor me vendosjen e barrës siguruuese dhe/ose barrës hipotekore/ sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së bllokuar/ shitja e pasurisë së sekuestruar/ kalimi i përgjegjësisë për detyrimin e papaguar tek palët e treta.
- ii. Pas dërgimit të Njoftimit dhe kërkesës për Pagesë, mund të merret masa e konfiskimit deri në 50% të xhiros ditore;
- iii. Kërkohet pezullim i veprimeve në QKB dhe Doganë.

26. Ankimimi bëhet:

- a. Pranë DAT të Ministrisë së Financave dhe të Bashkisë;
- b. Për vlerësimet e bëra nga administrata tatimore dhe çdo vendim tjetër që ndikon në detyrimin tatimor, përveç vlerësimit të bërë në mungesë të deklaratës tatimore;
- c. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;
- d. Pas pagesës ose vendosjes së garancisë për detyrimin që ankimohet, por jo për kamatëvonesat dhe gjokat;
- e. Edhe në rrugë gjyqësore kur akti është ankimuar më parë në rrugë administrative.

27. Gjambat dhe kamatëvonesat:

- a. Vendosen për deklarime dhe pagesa të detyrimeve tatimore përtej afateve ligjore;
- b. Aplikohen edhe për fshehje të detyrimit, moslëshim të faturave të shitjes dhe/ose kuponit tatimor, mosdeklarim të pagës reale, plotësim të gabuar të deklaratave tatimore, mosinstalimin dhe mosmirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, mosdeklarim të punonjësve, mosmbajtje të dokumentave tatimore/kontabël, etj.;
- c. Zbatohen të dyja së bashku, por kamatëvonesat fillojnë nga afati i pagesës dhe ndërpriten në datën e pagesës së detyrimit;
- d. Ndërsa gjambat mund të ankimohen, kamatëvonesat jo.

Kujdes: Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, për shkaqet e mësipërme, përveçse klasifikohen si evazion fiskal mund të bëhen edhe objekt i ndjekjes penale.

28. Kalimi në statusin pasiv tatimor:

- a. Mund të bëhet vetëm nga DRT nëse:
 - i. Pezullon aktivitetin duke aplikuar në QKB, për një afat të caktuar ose jo;
 - ii. Nuk dorëzon deklaratën tatimore përgjatë 12 muajve të fundit;
 - iii. Dorëzon deklaratat tatimore pa aktivitet për 12 muaj të njëpasnjëshëm;
- b. Të lejon ndërprerjen e deklaratave për të gjithë llojet e detyrimeve tatimore;
- c. Kërkon dorëzimin në DRT të numrave serial të blloqeve të faturave të shitjes të papërdorura.

Kujdes:

- a. Nuk pezullon dot aktivitetin në QKB, pa paguar më parë të gjitha detyrimet tatimore;
- b. Në statusin pasiv nuk mund të kryesh asnjë aktivitet;
- c. Duhet të dorëzosh deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për muajt e vitit në aktivitet.
- d. Për rifillimin e aktivitetit duhet të aplikosh në QKB. Kur kalimi në statusin pasiv është bërë direkt nga DRT, riaktivizimi bëhet me kërkesë pranë administratës tatimore.

29. Çregjistrimi bëhet:

- a. Deklaron vullnetarisht mbylljen e aktivitetit pranë QKB-së;
- b. Paraqet deklaratat tatimore të muajit të fundit dhe deklaratën vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

- c. Shlyen detyrimet tatimore ndaj administratës tatimore dhe Bashkisë;
- d. Brenda 30 ditëve nga aplikimi për mbylljen e aktivitetit, nëse nuk ke detyrime të papaguara

Kujdes:

- a. Edhe pas çregjistrimit mbetesh përgjegjës për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike.
- b. Dorëzo pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore blloqet e faturave të shitjes të papërdorura.
- c. Pas çregjistrimit në QKB, kontakto shoqërinë e autorizuar të kasës fiskale për çaktivizimin e saj.

Ky material është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe përmban informacion mbi të drejtat dhe detyrimet tatimore për kategorinë:

**Person Fizik me xhiro
deri 2 milionë Lekë**

Qendra e thirrjeve: 0800 00 02 (pa pagesë)

Orari: E Hënë - E Enjte ora 08:30 -18:00; E Premte ora 08:30-16:00



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Web: www.tatime.gov.al



European Bank
for Reconstruction and Development



**DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**